



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ÇËRRIK

Date: 08.11.2022

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Punime ne shkollen 9Vjeçare "Vasil Belshi " Shtermen +Punime ri ne konviktin e shkolles se mesme profesionale "Mihal Shahini" +punime hidroizolimi ne kopeshitin e femijeve Mollas+Banesa per familjet ne nevoje”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Punime ndërtimi 45210000-2

VLERA E FONDIT LIMIT: 5260980 (pese milion e dyqind e gjashtedhete mije e nenteqind e tetedhete) leke pa tvsh

Perlllogaritja e fondit limit dhe specifikimeve teknike eshte kryer nga inxhinier i bashkise referuar nenit 76 të pikës (a) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj)”, Inxhinieri është mbështetur ne manualin teknik te çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre nr.625 datë 15.07.2015,(ndryshuar me VKM-në nr.631,datë 26.10.2018 ,si dhe ne aktin normativ nr.10 date 18.05.2022” Per kompesimin financiar te cmimit per disa materiale ndertimi sipas percaktimit te kontrates per pune publike si pasoje e situates se vecante te krijuar ne treg gjate vitit 2022” me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë e matshme dhe njëkohësisht e të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Cerrik** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbeshtetje ne nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.

c. Formularin e Ofertës dhe Lista e Çmimeve sipas Shtojcave 1 dhe 2;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë plotësohet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare (2019, 2020, 2021), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% se fondit te vene ne dispozicion.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” Ne lidhje me situaten ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund te vendosin kerkesa qe garantojme qe operatoret ekonomike kane kapacitetin e nevojshem ekonomik dhe financiar per te zbatuar kontraten”, ”Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”, si dhe bazuar ne nenin 43, pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021

“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”: Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Duke marrë në konsideratë numrin e operatoreve ekonomik që ofrojnë këto lloj shërbimesh, sasinë dhe cilësinë e shërbimit objekt procedure prokurimi, afatin e kontrates dhe eksperiencat e mëparshme nga AK Bashkia Cerrik dhe Autoritete të tjera kontraktore kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohe dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së përllogaritur/ fondit limit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për tre vitet e fundit financiare (2019, 2020, 2021), të konfirmuara nga Administrata Tatimore, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Te shoqeruara nga Ekspert Kontabel i autorizuar në përputhje me ligjin nr.10091 datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar.”

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.*

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim/e për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2022 sipas afateve të maturuara/përcaktuara dhe parashikuara në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lëshuar prej njërive të vetëqeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron dhe ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin/et e lëshuar nga njëria/të e vetëqeverisjes vendore përkatëse.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, nëni 3.1/a, b, c dhe nëni 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

- b. Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit e kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:

- Për kontrata të realizuara me ente/institucione publike, OE duhet të paraqesë:
 - Formularin e vlerësimit, sipas shtojcës 9, shoqëruar me:
 - Kontratën/at e sipërmarrjes;
 - Situacionin përfundimtar të objektit;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Certifikatën e marrjes në dorëzim (të përkohëshme/përfundimtare)
- Për kontrata të realizuara me sektorin privat, OE duhet të paraqesë:
 - Formularin e vlerësimit, sipas shtojcës 9, shoqëruar me:
 - Kontratën/at e sipërmarrjes;

- *Situacionin përfundimtar të objektit;*
- *Aktin e kolaudimit;*
- *Faturën/at tatimore*

Në rast se oferta paraqitet nga bashkimi i operatorëve ekonomikë, pika 2.3.1, gërma “a”, plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1, gërma “b”, duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 30 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose vlerë jo më të vogël se dyfishin, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

2.3.2. Operatori Ekonomik ofertues duhet të disponojë dhe të paraqesë Licencën profesionale të shoqërise për realizimin e punimeve objekt kontrate, e cila duhet të përmbajë së paku kategoritë e mëposhtëme:

- N.P-1 A, *Punime germimi ne toke*
- NP-2 - A *(Ndertime civile dhe industriale)*
- N.P.3, -A *Rikonstruksion dhe mirembajtje godina civile dhe industriale, veshje fasada*
- NS-1- A *(Punime per prishjen e ndertimeve)*

Sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licencave profesionale sipas legjisllacionit në fuqi.

Për Operatorët e huaj të bëhet ekuivalentimi/njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit kompetent të autorizuar, në plotësimin e licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Kategoritë dhe nivelet e licencave të kërkuara janë bazuar në Lidhjen 3 dhe 4 të VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për Miratimin E Rregullores Për Kriteret Dhe Procedurat E Dhënies Së Licencave Profesionale Të Zbatimit, Klasifikimit Dhe Disiplinimit Të Subjekteve Juridike, Që Ushtrojnë Veprimtari Ndërtimi”

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N-P -1 A	<i>Punime germimi ne toke</i>	Germim dhe me krah e transport me k dore 10 m, kategoria IV Transport dheu dist 5km	A	0-20 milion
N-P- 2A	<i>(Ndertime civile dhe industriale)</i>	Punime special te shtresave te cilat perfshijne prishje shtresash, hidroizolime, hidroizolim etj	A	0-20 milion
N-P.3 -A	<i>Rikonstruksion dhe mirembajtje godina civile dhe industriale, veshje fasada</i>	I.Punime ne shkollen 9Vjeçare Shtermen	A	0-20 milion
NS-1- A	<i>Punime per prishjen e ndertimeve</i>	An 1 Prishje shtresa e nenshtresa ne tarace)leter h/izoluese+lluster cimonto 3cm + penobeton tm=20cm)	A	0-20 milion

NP 1A- Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet, vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

NP 2A- Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta, në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

NP- 3A – kemi te bejme me rikonstruksion godinash dhe banmesash ne nevojje.

NS 1A- Referuar zerave te preventivit per punimet dhe prishjen e ndertimeve nga brenda dhe jashtenderteses, gjate te cilave kryhen punime prishje, kontraktuesi duhet te marre masa qe te mbroje godinat, gardhet, muret rrethues dhe strukturat qe gjenden ne afersi te objektit, ku po kryhen keto punime prishese. Per kete, duhen evituar mbingarkesat nga te gjitha anet e strukturave nga grumbuj dhe materiale. Kur grumbujt dhe materialet duhen zbritur poshte, duhet pasur kujdes qe te parandalohet shperndarja ose renia e materialeve, ose te projektohet ne menyre te tille, qe mos te perbeje rrezik per njerezit, strukturat rrethuese dhe pronat publike te cdo lloji. Kemi prishja e elementeve te godines si: prishja e shtresave dhe e taracave, prishja e dysHEMEVE, prishja e veshjeve etj

2.3.3. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë një punësim mesatar prej të paktën 30 (tridhjetë) punonjës të siguruar, për tre muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, të vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve, për secilin muaj të kërkuar;
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohe nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohe që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave te preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga specialistet e fushes.

2.3.4. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar staf teknik (drejtues teknik) për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune noteriale të vlefshme dhe diplomë, të figurojnë në licencën profesionale të shoqërisë në zbatim, si dhe në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, si mëposhtë:

- 1(nje) inxhinier ndërtimi
- 1 (nje) inxhiner elektrik
- 1 (nje) inxhiner mekanik

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

1 nje Inxhinier ndertimi

Kerkohe Inxhinieri pasi kemi te bejme me rikonstruksione te objekteve. Referuar projektit dhe preventivit te punimeve te zbatimit, do te kryhen punime, te cilat kerkojne detyrimisht mbikqyrjen nga inxhinieri i ndertimit gjate gjithë periudhes te zbatimit te punimeve.

1 inxhinier elektrik

Kerkohe inxhinieri elektrik, pasi referuar projektit dhe preventivit te punimeve te zbatimit, do te kryhen instalime elektrike te cilat jane te percaktuara ne preventivin fillestar e perkatesisht ne sesioni B, zerat 1,2,3,6,7 etj.

1 inxhinier mekanik

Kerkohe inxhinieri mekanik, pasi referuar projektit dhe preventivit te punimeve te zbatimit, do te kryhen punime te strukturave metalike neper strehat e objektit. E kemi kerkuar kete inxhinier per arsye se mund te kete problematika gjate zbatimit te punimeve dhe mund te kete ndryshime dhe rregullime te cilave mund ti pergjigjet gjate zbatimit inxhinieri perkates. Si dhe eshte e domosdoshme asistenca e inxhinierit per çdo defekt te mundshem te mjeteve qe do te perdoren gjate zbatimit te punimeve.

2.3.5. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar staf mbështetës të kualifikuar, i cili duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë të paktën për 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, minimalisht:

- 1 Punonjës me dëshmi trajnimi si “Specialist për sigurinë dhe shëndetin në punë”. Kontratë noteriale të punës si dhe certifikatë trajnimi “Për përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”.
- 2 (dy) Specialiste të certifikuar për punime në lartësi. Kjo të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve: kontratë pune noteriale, si dhe dokumentin e perkates te certifikimit
- 2 Teknike hidroizolues shoqëruar me diplome/deftese, kontratë pune noteriale dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik ISHTI
- 2 Teknike mekanik shoqëruar me diplome/deftese, kontratë pune noteriale dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik ISHTI,
- 2 Teknik ndërtimi shoqëruar me kontratë pune noteriale dhe diplome/deftese.
- 3 (tre) hekurkthyes shoqëruar me kontratë pune noteriale dhe certifikate deshmi perkatese te kualifikimit profesional (deshmi profesionale)
- 3 (tre) karpentiere shoqëruar me kontratë pune noteriale dhe certifikate deshmi perkatese te kualifikimit profesional (deshmi profesionale)
- 2 (dy) hidraulike shoqëruar me kontratë pune noteriale dhe certifikate deshmi perkatese te kualifikimit profesional (deshmi profesionale)
- 3 bojaxhi shoqëruar me kontratë pune noteriale dhe certifikate deshmi perkatese te kualifikimit profesional (deshmi profesionale)

- 1 elektrikist shoqëruar me kontratë pune noteriale dhe certifikate deshmi perkatese te kualifikimit profesional (deshmi profesionale).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

- 2 specialiste te certifikuar per lartesi – jane te nevojshem per shkak se do te kryhen punime ne taraca, do te kete punime ne lartesi e perkletesisht ne zerat: *Patim brezi me lartesi 130cm ne koridorin e katit te dyte+kati pare*
- 2 Teknike hidroizolues- jane te nevojshem sepse parashikohen volume konkrete pune e perkatesisht ne zerat : 3 *An H/izolim me leter katrama ne te ftohte, Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1 shtrese k katrama(sip.18.87mX3.21m+ hidroizolimi I murit vertikal 18.87mX0.3m etj.*
- 2 Teknik ndërtimi- jane te nevojshem sepse parashikohen volume konkrete pune ne preventivin fillestar e perkatesisht ne zerat : *Çati vendi zakonshme HD~8m, mbuluar, tjegulla marseleze, Shtrese derrasa FM 2.5cm etj*
- 3 (tre) hekurkthyes - jane te nevojshem sepse parashikohen volume konkrete pune ne preventivin fillestar e perkatesisht ne zerat: *Skele metalike me tubo fasade > 12m, vendopsje e kthim hekuri etj*
- 3 (tre) karpentiere - jane te nevojshem sepse parashikohen volume konkrete pune ne preventivin fillestar e perkatesisht ne zerat: *Brez b/a C 16/20, h ~ 8 m, Kollona b/a monolite C - 16/20, h ~ 4 m, Trare e arkitrare b/a C - 16/20, h ~ 4 m, Soleta te plota b/a C 20/25 t = 10 cm, h ~ 4m etj.*
- 2 (dy) hidraulike- jane te nevojshem sepse parashikohen volume konkrete pune ne preventivin fillestar e perkatesisht ne zerat : *Rubineta 1/2" etj*
- 3 bojaxhi - jane te nevojshem sepse parashikohen volume konkrete pune ne preventivin fillestar e perkatesisht ne zerat: *Kruejtje e stukim ne 5 klasat + ambienti i televizorit ne katin e dyte dhe 4 klasat ne katin e pare +tavni I zyres se pergjegjesit te konviktit*
- *Kruejtje e stukim ne koridorin e katit pare + kati i dyte, Patim brezi me lartesi 130cm ne koridorin e katit te dyte+kati pare, Patim ne zyren e pergjegjesit te konviktit(kati i pare), Lyerje boje plastike hidromat , Boje vaji mbi siperfaqe te patinuar ne brezin e patinuar ne karidoret e katit pare dhe te dyte +zyra e prgjegjesit etj.*
- 1 elektrikist - jane te nevojshem sepse parashikohen volume konkrete pune ne preventivin fillestar e perkatesisht ne zerat: *F.V Çelesa 10 A me nulifikim, F.V priza shuko brenda murit 2 fazore 25 A "Gevis" , F.V Portollampa normale 10 A etj*

2.3.6. Operatori Ekonomik ofertues, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

<i>Nr.</i>	<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Statusi</i>
1	<i>Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min.10 ton</i>	<i>2 copë</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
2	<i>Kamionçinë 3-5 ton</i>	<i>3 copë</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
3	<i>Eskavatore</i>	<i>3 cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
4	<i>Autopome betoni</i>	<i>2 cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
5	<i>Pompë suvatimi</i>	<i>3 copë</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>

6	Gjenerator	1 copë	Ne pronesi ose me qera
7	Depozitë uji 3.000-5.000 litra	2 copë	Ne pronesi ose me qera
8	Autovinç	2 copë	Ne pronesi ose me qera
9	Skela dhe rrjetë mbrojtëse	500m ²	Ne pronesi ose me qera
10	Vibrator	2 copë	Ne pronesi ose me qera
11	Autobot uji	1 copë	Ne pronesi ose me qera
12	Betoniere kantieri 1.5-3 m ³	2 copë	Ne pronesi ose me qera
13	Vinç karele	1 copë	Ne pronesi ose me qera
14	Matrapik	2 copë	Ne pronesi ose me qera
15	Nivelues betoni	1 copë	Ne pronesi ose me qera
16	Minieskavator	1 copë	Ne pronesi ose me qera

Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve dhe personelit, si më poshtë:

1. Kokore, minimumi 30 copë.
 2. Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi, minimumi 15 copë.
 3. Komplet i ndihmës së shpëjtë, minimumi 3 copë.
 4. Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila, minimumi 3 copë.
- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, të cilat janë në pronësi, nëse parashikohet nga legjislacioni në fuqi, duhet të paraqitet dokumentacion i vlefshëm si vijon: -certifikata e pronësisë; -leja e qarkullimit; -certifikata e kontrollit teknik; -polica e sigurimit të detyrueshëm (siguracioni); -leje/certifikata e transportit të mallrave për mjetet e transportit, lëshuar nga organet kompetente;
 - Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, të cilat janë të disponuara me qira, nëse parashikohet nga legjislacioni në fuqi, duhet të paraqitet dokumentacion i vlefshëm si vijon: -kontrata noteriale e qirasë; -certifikata e pronësisë së qiradhënësit; -leja e qarkullimit; -certifikata e kontrollit teknik; -polica e sigurimit të detyrueshëm (siguracioni); -leje/certifikata e transportit të mallrave për të tretë dhe me qira për mjetet e transportit, lëshuar nga organet kompetente;
 - Për pajisjet/makineritë/mjetet e tjera, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata noteriale e blerjes / akt-zhdoganimi / faturë tatimore / çdo dokument që vërteton fitimin e pronësisë mbi sendin sipas Kodit Civil të RSH. Ndërsa për pajisjet/makineritë/mjetet e tjera të disponuara me qira ose kontratë noteriale furnizimi, krahas dokumentacionit të mësipërm duhet të paraqitet edhe kontrata noteriale e qirasë e vlefshme.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të

dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga projektuesi. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018), si dhe hapësirat fizike rreth objektit mundësive të manovrimit me mjete të renda.

Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve.

2.3.7. Shoqëritë e huaja duhet të kenë kryer ekuivalentimin (njehsimin) e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturas, Republika e Shqipërisë, sic përcaktohet në *Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM Nr.42, date 16.01.2008.*

- Ofertuesi duhet të paraqesë certifikatë për cilësinë së punimeve **ISO 9001** (e vlefshme).
- Ofertuesi duhet të paraqesë certifikatë për sistemin e menaxhimit të mjedisit **ISO 14001** (e vlefshme).
- Ofertuesi duhet të paraqesë certificate për menaxhimin e rrisqeve rreth shendetit dhe sigurimit në punë” ekuivalente të vlefshme **ISO 45001:2018**

Certifikatat ISO duhet të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi : Kërkesat e mesiperme janë vendosur në zbatim të ligjit 162/2020 Për prokurimin Publik dhe VKM- nr. 285 date 19.05.2021 “ Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” nëni 39 pika 6 Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose ..

ISO 9001:2015 mbi " Sistemet e menaxhimit të cilësisë " ekuivalente të vlefshme

Kjo certifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarte të cilësisë , e cila mundëson

implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës.

ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të ambientit “ ekuivalente e vlefshme

Eshtë standarti më i përdorur në botë për sistemet e menaxhimit të mjedisit. Rikonstrukcioni I objektit konkret, përveçse kërkojnë një kapacitet me makineri kanë edhe një ndikim në mjedis për shkak të kushteve në të cilat realizohen si ndotja e ajrit nga pluhurat e kantierit ndotja akustike dhe mjedisore nga makinerit etj, aq me teper qe kemi te bejme me dy objecte brenda ne qytet. Për këtë arsye cdo operator ekonomik duhet të jetë i certifikuar për menaxhimin e ambientit. Eshtë në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore.

ISO 45001:2018 mbi “Standart për menaxhimin e rrisqeve rreth shëndetit dhe sigurimit në punë” ekuivalente e vlefshme

Sistemi i manaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në vendet e punës mundeson që çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga inxhinieri i bashkise dhe gjenden bashkengjitur ne spe bashke me dokumentat e tjere te tenderit.

Njesia e Prokurimit
